



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Himarë , më 04.08.2022

Lënda: Kthim përgjigjeje të kërkesës suaj për informacion në platformën elektronike e-mail datë 26.07.2022.

Znj. _____

Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 26.07.2022 ardhur me postë elektronike (e-mail) , ku kërkohet “Kërkesë për informacion” pranë Bashkisë Himarë. Për sa më sipër po ju përgjigjemi pyetjeve sipas renditjes së bërë në kërkesën tuaj:

- 1- A ka bashkia buxhet vjetor të planifikuar për rininë (grup moshën 15-29 vjeç)? Nëse po, sa përqind të shumës totale të buxhetit zënë këto zëra? Nëse jo, ju lutem a mund të na tregoni disa nga arsyet përse nuk ka një planifikim të tillë?
 - Për vitin 2022, bashkia ka parashikuar shpenzime të cilat përfshijnë grup moshën 18-29 vjeç duke përfshirë trajnime profesionale, evente të ndryshme rinore gjatë vitit, mbështetje financiare për evente kulturore, ndërtime të ambienteve sportive etj, në masën 5.16% të totalit të shpenzimeve operative dhe investime.
- 2- A ka të punësuar pranë bashkisë suaj individë të moshës 18-29 vjeç (përfshirë drejtuesit)? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj?
 - Po, ka individë të punësuar të cilët janë përkatësisht 8 femra dhe 13 meshkuj të moshës 18-29 vjeç.
- 3- Sa është përqindja e të rinjve (18-29 vjeç) të punësuar krahasuar me numrin total të administratës?
 - Përqindja e kësaj grup moshe është 11.5 %.
- 4- A ka bashkia juaj politika rinore të zhvilluara specifikisht për grup moshën 15-29 vjeç? Nëse po a mund të na dërgoni një kopje të tyre? Nëse jo a mund të na tregoni disa nga arsyet përse përse nuk ka të zhvilluar një politikë të tillë?
 - Nuk kemi politika rinore të zhvilluara për arsye se nuk kemi ngritur këshillin rinor vendor.
- 5- A keni në institucionin tuaj struktura përgjegjëse për politikat rinore? Nëse po, cilat janë ato (psh. drejtori, sektorë, specialistë, struktura përfaqësimi rinor politikë etj) dhe prej sa kohësh janë funksionale?
 - Kemi 1 specialist të arsimit dhe të rinisë i cili është funksional prej 1 viti.

- 6- A ka struktura rinore të ngritura në bashkinë tuaj dedikuar grupmoshës së të rinjve 15-29 vjeç (qendra/zyra rinore, këshilla rinore, parlament rinor, struktura konsultative rinore, etj.) për periudhën janar-dhjetor 2021. Nëse po, cilat janë ato?
- Jo, nuk kemi aktualisht, por jemi duke kryer procesin e ngritjes së këshillit rinor vendor.
- 7- Me kë keni bashkëpunuar për ngritjen e strukturave të tilla (me grupe të rinjsh, organizata rinore, etj)
- Kemi bashkëpunuar me Ministrinë e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, e cila ka zhvilluar disa trajnime për ngritjen e ketyre strukturave.
- 8- A keni pasur ju forma të tjera bashkëpunimit (me grupe të rinjsh, organizata rinore, etj) për zhvillimin e aktiviteteve me fokus rininë? Nëse po ku kanë konsistuar ato?
- Jo, nuk kemi patur forma të tjera bashkëpunimi.
- 9- Sa është me përafërsi pjesëmarrja e të rinjve në konsultimet publike të zhvilluara nga bashkia? Cilat janë disa nga mjetet apo mekanizmat që përdor bashkia në përfshirjen e të rinjve në të tilla procese?
- Rreth 10-15 % e të rinjve. Mekanizmat që përdor bashkia për përfshirjen e të rinjve në të tilla procese janë rrjetet sociale dhe faqen e web-it të institucionit.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin!